



KOLEGJI UNIVERSITAR
BEDËR

PLANI STRATEGJIK INSTITUCIONAL
2018-2023

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	2
II.	ANALIZA STRATEGJIKE.....	4
A.	ARSIMI I LARTË NË SHQIPËRI	4
B.	POZICIONI STRATEGJIK I KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”	5
III.	OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE STRATEGJITË E ZBATIMIT	6
A.	DREJT NJË ARSIMI MË CILËSOR	6
B.	CILËSIA E KËRKIMIT SHKENCOR.....	8
C.	PRANIMI I STUDENTËVE	9
D.	JETA STUDENTORE DHE MARRËDHËNIA ME TË DIPLOMUARIT	10
E.	NDIKIMI I QËNDRUESHËM	12
F.	PËRGJEGJËSIA SOCIALE	14
G.	BURIMET NJERËZORE	15
H.	INFRASTRUKTURA DHE BURIMET FINANCIARE	16

I. HYRJE

Arsimi i lartë synon që, në bazë të vlerave, si liria e shprehjes, autonomia dhe liria akademike, lëvizja e studentëve dhe e personelit, të zhvillojë dhe të përmirësojë sistemet në të gjitha sferat duke i bërë ato më të përshtatshme dhe më konkurruese dhe duke forcuar mekanizmat e tyre të sigurimit të cilësisë, me qëllim kryesor integrimin me tregun dhe rritjen e mundësive objektive për punësimin e të diplomuarve.

Në hartimin e këtij plani strategjik janë vlerësuar disa prej prirjeve më të rëndësishme, të cilat kanë sjellë një ndikim domethënës në fushën e arsimit të lartë:

-Mësimdhënia me në qendër studentin, synon të kapërcejë disa prej problemeve që lidhen me metodat tradicionale të mësimdhënies në arsimin e lartë, duke u përqendruar te studentët dhe nevojat e tyre.

-Strategjia e të mësuarit gjatë gjithë jetës, e njohur si një element thelbësor dhe i domosdoshëm për t'u përballur me sfidat e konkurrencës, synon përdorimin e teknologjive të reja, duke pasur si objekt përmirësimin e kohezionit social dhe të mundësive të barabarta për cilësinë e jetës.

-Punësimi i studentëve të diplomuar mbetet gjithmonë një nga matësit universalë të cilësisë dhe të vlerës që ka universiteti sipas diploma që ai lëshon, duke bërë ballafaqimin me tregun e punës, ku studenti atë që ka investuar në vite duhet ta kthejë në të mira për veten, familjen dhe shoqërinë. Në këtë kontekst, punësimi rezulton në rritjen e mundësive që u krijohen të diplomuarve për të promovuar veten dhe institucionin, ku kanë kryer studimet.

-Nxitja e kërkimit shkencor dhe inovacionit, si një forcë shtytëse për zhvillimin ekonomik dhe social por dhe për të ruajtur një bazë të gjerë dijeshe për shoqërinë, duhet të bëjë pjesë në qëllimet e institucioneve të arsimit të lartë, përkrah përgatitjes së studentëve për jetën e tyre profesionale, qytetarinë aktive dhe zhvillimin e tyre personal.

-Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve, personelit akademik e kërkimor është një prirje gjithnjë në rritje dhe duhet të jetë një përparësi, sepse ai është i lidhur ngushtë me rritjen e produktivitetit shkencor dhe progresin e karrierës.

-Rritja e partneritetit midis institucioneve të arsimit të lartë, por edhe të tjerë, e nisur fillimisht si marrëveshje e thjeshtë për shkëmbimin e studentëve, është kthyer në një praktikë të rëndësishme, popullariteti i të cilës është rritur ndjeshëm gjatë 20 viteve të fundit. Kohët e fundit, marrëveshjet ndërdisiplinore, ku universitetet që veprojnë në fusha të ndryshme zhvillojnë një program të përbashkët, po bëhen gjithmonë e më të zakonshme.

-Përdorimi në mënyrë sa më të mirë i teknologjisë në arsimin e lartë ka një ndikim të qartë në modelet e mësimdhënies dhe proceset e të mësuarit. Disponueshmëria në internet e kurseve të ofruara nga profesorët më të mirë dhe më të njohur nga universitetet prestigjioze është një mundësi, por gjithashtu edhe një sfidë, e cila ka ndikim të qartë për procesin mësimor.

-Rritja e dimensionit social të arsimit të lartë është një tjetër sfidë që duhet të mbështetet te hartimi dhe ndjekja e politikave arsimore për shtresat sociale të pamundura ekonomikisht, dhe ato të prekshme, duke përfshirë edhe mobilitetin ndërkombëtar për këto shtresa, veçanërisht nxitjen e

mobilitetit të studentëve të fushës së edukimit, në funksion të rolit të rëndësishëm që ata do të luajnë në edukimin e brezave të ardhshëm.

Prirjet e sipërpërmendura janë të lidhura në mënyrë të ngushtë me strategjitë institucionale, ku nga njëra anë ato pasqyrojnë kërkesat në rritje të një modeli arsimor ndërkombëtar dhe nga ana tjetër i përgjigjen kërkesave dhe nevojave që kanë punëdhënësit kryesorë në vend dhe ata europianë nga rezultatet e arsimit të lartë.

II. ANALIZA STRATEGJIKE

A. ARSIMI I LARTË NË SHQIPËRI

Sistemi universitar në Shqipëri ka pësuar ndryshime, të cilat kanë rritur konkurrencën brenda vendit dhe kanë liberalizuar pranimet në universitet. Në bazë të këtyre ndryshimeve, në vitin 2003, Shqipëria u pranua anëtare me të drejta të plota në "Kartën e Bolonjës".

Institucionet e arsimit të lartë janë të organizuara në institucione publike, jopublike dhe publike të pavarura, të cilat ofrojnë programe studimi të licencuara, për të cilat lëshojnë diploma pas akreditimit të institucionit dhe programit të studimit.

Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe studimi të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe studimi në cikle të ndryshme, në varësi të llojit të institucionit, si dhe programe me karakter profesional të lartë dhe programe të formimit të vazhduar në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet e kërkuara.

Reformimi i sistemit të arsimit të lartë ka qenë një nga përparësitë kyçe të viteve të fundit, veçanërisht në drejtim të konsolidimit të trajtimit të arsimit të lartë si shërbim dhe e mirë publike. Për rrjedhojë, një nga qëllimet kryesore të kësaj reforme ka qenë ruajtja e parimeve bazë të arsimit të lartë, si: cilësia, mundësia e barabartë, mbështetja për shtresat në nevojë, konkurrenca e lirë, hyrja për të gjithë mbi bazën e meritës, mbështetja nëpërmjet kërkimit shkencor e përparësive strategjike të zhvillimit të vendit, si dhe krijimi i mekanizmave për rritjen e përgjegjshmërisë ndaj shoqërisë dhe interesit publik.

Në institucionet e arsimit të lartë një vend të rëndësishëm zë kërkimi shkencor, shtrirja e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe strukturat e realizimit të tij. Pjesë e rëndësishme e reformës në arsimin e lartë, në lidhje me kërkimin shkencor, është konsideruar vlerësimi i cilësisë së tij, nëpërmjet procedurave të miratuara dhe reflektimit të rezultateve të tij në renditjen e institucioneve.

Cilësia e mësimdhënies ka qenë fokusi i kësaj reforme, duke përcaktuar objektiva të qartë për përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet përfshirjes së vlerësimit të jashtëm dhe atij të brendshëm.

Bazuar në këto ndryshime ligjore, institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore-shkencore.

B. POZICIONI STRATEGJIK I KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”

1. Misioni

Misioni i Kolegjit Universitar "Bedër" është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë.

2. Vizioni

Vizioni i Kolegjit Universitar “Bedër” synon që të jetë një institucion elitar i arsimit të lartë në vend dhe rajon për të qenë alternativa e parë e edukimit dhe kërkimit shkencor për shqiptarët, kudo që ndodhen.

Kolegji Universitar "Bedër" synon të shndërrohet në një institucion arsimor me karakter ndërkombëtar, duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të huajt, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qendër rajonale e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Profili i Kolegjit Universitar “Bedër”

Kolegji Universitar “Bedër” është një institucion i cili funksionon mbi baza jofitimprurëse dhe mbështet studentët e suksesshëm, të cilët duan të vazhdojnë studimet e larta pranë tij.

Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Programet e studimit në të dyja ciklet organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga “Karta e Bolonjës” dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë.

Kolegji Universitar “Bedër” synon krijimin dhe konsolidimin e një profili ndërkombëtar, duke mundësuar pranimin e studentëve nga trevat shqipfolëse në rajon dhe në diasporë, si edhe nga disa vende të Europës dhe më gjerë. Përbërja e personelit akademik, pasqyron gjithashtu profilin ndërkombëtar të kolegjit, i cili përforcohet me marrëveshjet e bashkëpunimit të vendosura me universiteteve dhe kompani në disa vende të botës.

Aktivitetet me bazë kërkimore janë një kriter i rëndësishëm për profesionalizmin që karakterizon punën në KUB. Kolegji Universitar “Bedër”, që nga fillimi i aktivitetit akademik, ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare të hapura, veprimtari kualifikuese e nxitëse, duke dhënë kontributin e tij në shkencë dhe shoqëri.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE STRATEGJITË E ZBATIMIT

A. DREJT NJË ARSIMI MË CILËSOR

Qëllimi

Kolegji Universitar “Bedër” ka si qëllim të sigurojë një arsim cilësor, i cili bëhet garanci për studentët e diplomuar që ndihen të aftë brenda mundësive që ofron tregu i punës. KUB inkurajon mendimin kritik, inovacionin dhe aspiratën për të arritur progres dhe sukses, brenda dhe përtej institucionit, dhe u mundëson studentëve të aplikojnë vlerat dhe aftësitë e fituara në çdo aspekt të jetës dhe karrierës së tyre të ardhshme. KUB synon të arrijë qëllimet e tij arsimore, duke vendosur një theks të veçantë mbi kërkimin shkencor, balancimin e programeve të studimit dhe një cilësi arsimi, që i pajis studentët me aftësi praktike për një integrim më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

a. **Sigurimi i një arsimi cilësor që promovon nëpërmjet vlerësimit mendimin kritik dhe përgatitjen e studentëve për identifikimin, ndërtimin dhe vlerësimin e argumenteve**

Nisma për konkretizim

- Të synohet drejt një qasjeje e cila si në procesin e mësimdhënies, ashtu edhe atë të vlerësimit, i aftëson studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur, si mënyra më efektive për t’i përgatitur për sfidat e ardhshme.
- Të kalohet në një metodologji vlerësimi, e cila bazohet plotësisht në ndërtimin e aftësive të të menduarit kritik, në vend të mënyrave tradicionale të vlerësimit.
- Të kalohet nga metodologjia e vlerësimit tradicional në ese dhe prezantime.
- Mësimdhënia dhe vlerësimi në KUB të sigurojë për të gjithë studentët, mundësi të shkëlqyera për të përmbushur potencialin e tyre të plotë akademik.
- Të formohet një mjedis edukimi që inkurajon studentët për të ngritur pyetje të arsyeshme.
- Të monitorohet progresi akademik dhe rezultatet në mënyra alternative.

b. **Sigurimi i një cilësie arsimore që i pajis studentët me aftësi praktike për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës**

Nisma për konkretizim

- Të ndryshohet strategjia aktuale e punësimit të lektorëve me orar të pjesshëm, me qëllim që të ftohen në çdo lëndë, duke siguruar dhënien e aftësive praktike në fushat përkatëse të ekspertizës së tyre.
- Të bashkëpunohet midis departamenteve për ofrimin e kurseve, të cilat sigurojnë kombinimin e përshtatshëm të leksioneve, praktikës mësimore dhe punës praktike.
- Të bashkëpunohet midis departamenteve për të siguruar leksione të përbashkëta për studentët e interesuar nga të gjitha departamentet dhe disiplinat.
- Të sigurohet integrim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet njësive kryesore, si zyra e planifikimit të karrierës, këshilltarët akademikë, zyra e studentëve etj.
- Të sigurohet një sistem arsimi i kompjuterizuar, i cili do të garantojë mësimin 'online', si dhe një komunikim më të mirë brenda universitetit.
- Të ruhet marrëdhënia e ngushtë me organet studentore, në mënyrë që të përmirësohet mbledhja dhe përdorimi i informacionit të marrë nga studentët dhe të diplomuarit.

c. Rritja e mundësive dhe përvojave ndërkombëtare për studentët**Nisma për konkretizim**

- Të zgjerohen trajnimet ndërkombëtare, si një tipar dallues i Kolegjit Universitar "Bedër", veçanërisht kur kombinohen me mësimin dhe punën praktike, ku studentët mund të punojnë dhe të njihen me përvoja dhe kultura të tjera;
- Vetëdija kulturore të kthehet në një pjesë qendrore për programet dhe përvojat ndërkombëtare;
- Të zgjerohen mundësitë për aktivitete, si mundësitë e praktikës ndërkombëtare, konkurset studentore dhe praktikat mësimore, duke i transformuar ato në një komponent të rëndësishëm arsimor;
- Të sigurohet përfshirja në programet ndërkombëtare, të cilat të jenë të mjaftueshme për të promovuar dhe mbështetur përvoja arsimore të një cilësie të lartë;
- Të nxitet bashkëpunimi me universitetet jashtë vendit, me qëllim nxitjen e shkëmbimit të studentëve, duke qenë përzgjedhës, lidhur me numrin e programeve.

B. CILËSIA E KËRKIMIT SHKENCOR

Qëllimi

KUB synon të sigurojë një komunitet kërkimor të suksesshëm dhe ndërveprues që gjeneron ide, krijon fusha të reja të dijes dhe ndikon në ndryshimin dhe zhvillimin shoqëror, kulturor, mjedisor të Shqipërisë dhe komuniteteve globale. Hulumtimi ynë përfshin personelin akademik, si dhe studentë të programit “Bachelor” dhe “Master”.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. Nxitja dhe mbështetja e pjesëmarrjes aktive të personelit akademik dhe studentëve të programit “Bachelor” dhe “Master” në projekteve dhe veprimtari kërkimore-shkencore

Nisma për konkretizim

- Të rritet niveli aktual i angazhimit dhe produktiviteti i personelit akademik, studentëve të diplomuar dhe atyre aktualë;
- Të ofrohen bursa dhe mbështetje për motivimin e personelit për rritjen e numrit të publikimeve;
- Të rritet produktiviteti i organizimit të takimeve të punës (workshopeve), konferencave, seminareve, trajnimeve dhe simpoziumeve, të organizuara në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të aplikohet për fonde nga Bashkimi Europian dhe institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për projektet kërkimore;
- Të krijohen mekanizma të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për matjen e rezultateve të aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe ato profesionale.

2. Mbështetja e inovacionit dhe ideve që ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë dhe rritjen e ndikimit ndërkombëtar të institucionit

Nisma për konkretizim

- Të përfshihet personeli dhe studentët në shprehjen e ideve, mbështetjen e inovacionit dhe të motivohen që të fitojnë dhe të përdorin aftësitë e tyre sipërmarrëse dhe menaxhuese;
- Të zgjerohet gama e programeve të zhvillimit personal dhe profesional, duke përfshirë bursat, aksesibilitetin dhe burimet mësimore;
- Të promovohet shkëmbimi inovativ i personelit me industrinë, institucione të ndryshme dhe ofruesit e shërbimeve publike;

- Të nxiten lidhjet me biznesin dhe komunitetin financiar për të mbështetur inovacionin dhe aktivitetet e institucionit që kanë të bëjnë me tregun.

C. PRANIMI I STUDENTËVE

Qëllimi

Kolegji Universitar “Bedër” synon të sigurojë një nivel cilësor në rritje të studentëve të pranuar, nëpërmjet rritjes së aftësive të komisioneve të promovimit të institucionit në shkollat e mesme dhe në pranimin e studentëve dhe forcimit të vazhdueshëm të kritereve të pranimi të studentëve në programet “Bachelor” dhe “Master”.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. Rritja e cilësisë së pranimi nëpërmjet tërheqjes dhe diplomimit të një trupe cilësore e të larmishme studentësh

Nisma për konkretizim

- Të rishikohen dhe të përditësohen proceset e pranimi, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe efektiviteti i praktikave më të mira të universitetit;
- Të synohet për tërheqjen e studentëve më të mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të ruhet politika aktuale që synon cilësinë dhe jo sasinë, duke përcaktuar numrin e studentëve, në përputhje me cilësinë dhe aftësinë e kandidatëve dhe mundësitë reale për të ofruar një arsimim të nivelit të lartë;
- Të sigurojë për të gjithë studentët mundësi të barabarta për të përmbushur potencialin e tyre të plotë nga mësimdhënia dhe vlerësimi në KUB;
- Të monitorohet në vazhdimësi rezultati dhe progresi akademik si elemente kyç për realizimin e këtij objekti.

2. Rritja e promovimit të institucionit dhe e programeve të studimit me qëllim tërheqjen e studentëve më të mirë

Nisma për konkretizim

- Të intensifikohen aktivitetet promovuese akademike dhe kulturore;
- Të zgjerohen përpjekjet për të tërhequr studentë me potencial pas shpalljes së rezultateve të Maturës Shtetërore dhe gjatë fazave të aplikimit për në shkollën e lartë;

- Të promovohen programet e studimeve dhe aktiviteteve të kryera nga Kolegji Universitar “Bedër”, përmes të gjitha mjeteve të komunikimit masiv;
- Të promovohen nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit, fakultetet, departamentet dhe njësitë e ndryshme të KUB, si dhe të kryhet përditësimi periodik i tyre;
- Të organizohen vizita promovuese, seminare dhe workshope nëpër shkolla të mesme, së bashku me studentët që kanë mbaruar në shkollat respektive, me qëllim shpалosjen e avantazheve që ofron KUB;
- Të zhvillohen konkurse dhe projekte për nxënësit në shkollat e mesme;
- Të rritet pjesëmarrja në panairë arsimore brenda dhe jashtë vendit dhe shpërndarja e informacioneve, në lidhje me mundësitë e mbështetjes (bursa, akomodimi etj.);
- Të bashkëpunohet me institucione publike dhe private, me organizata jofitimprurëse për tërheqjen e studentëve që vijnë nga kategori të ndryshme sociale;
- Të organizohen shkolla verore me tema të ndryshme për nxënësit e gjimnazeve;
- Të organizohen ditët e hapura dhe të orientimit për studentët e rinj;
- Të krijohen lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale, me qëllim rritjen e mundësive për të thithur maturantë cilësorë;
- Të konsolidohet mbështetja financiare për studentët e suksesshëm dhe të talentuarit në fusha të ndryshme.

D. JETA STUDENTORE DHE MARRËDHËNIA ME TË DIPLOMUARIT

Qëllimi

Kolegji Universitar “Bedër” synon të krijojë një mjedis multikulturor, që ndikon në rritjen e cilësisë së jetës studentore, duke i bërë studentët të ndihen në qendër të vëmendjes së një institucioni, i cili ka në qendër të vëmendjes studentin jo vetëm gjatë jetës studentore, por edhe në atë profesionale.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. Rritja e mbështetjes së studentëve nga strukturat institucionale në veprimtarinë akademike dhe aftësimin për tregun e punës

Nisma për konkretizim

- Të ndiqen politika mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të këshillimit;
- Të mbështeten studentët për zgjidhjen e nevojave të tyre në të gjitha ciklet e studimeve, nëpërmjet strukturave të këshilltarëve akademikë dhe këshilltarëve të karrierës;
- Të përgatiten studentët për tregun e punës, nëpërmjet seminareve, trajnimeve dhe konferencave të orientuara drejt karrierës;
- Të kërkoen mundësi punësimi për të gjithë të diplomuarit në programet “Bachelor” dhe “Master”;
- Të mbështetet nga institucioni organizimi i stazheve të punës në sektorët publikë dhe privatë;
- Të ndiqet një politikë mbështetëse për grupe sociale të veçanta, në nevojë;
- Të stimulohen studentët për të marrë pjesë në konferenca studentore dhe projekte të ndryshme kërkimore;
- Të sigurohet lidhja e marrëveshjeve me institucione publike dhe kompani private për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve nga ana e tyre;
- Të përditësohet biblioteka sipas fushave përkatëse, si dhe stimulimi i studentëve në përdorimin e bibliotekës online.
- Të përditësohet dhe të zhvillohet sistemi i informacionit, për të lehtësuar hyrjen në të studentëve.

2. Mbështetja e klubeve studentore dhe veprimtarive sociale, kulturore e sportive për të siguruar një eksperiencë sa më të plotë të jetës studentore

Nisma për konkretizim

- Të zhvillohen nga klubet studentore për studentët, në përputhje me rregullat, mjedisin dhe disiplinën në KUB, aktivitete sociale, kulturore, intelektuale dhe sportive.
- Zyrat administrative të angazhohen në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe kulturore;
- Institucioni të nxisë angazhimin e studentëve në aktivitete sportive të niveleve të larta;
- Të mbështetet fuqimisht integrimi i studentëve në jetën kulturore të qytetit dhe më tej;
- Të hartohen politika integrimi për studentët që vijnë nga shtete të tjera;

- Të krijohet infrastruktura e nevojshme për mundësimin e zhvillimit të aktiviteteve të klubeve;
- Të mundësohet ofrimi i terreneve sportive dhe për aktivitete të tjera për zhvillimin e studentëve.

3. *Ruajtja e një marrëdhënieje të konsoliduar dhe në vijim me studentët e diplomuar, nëpërmjet bashkëpunimit, zhvillimit të rrjeteve profesionale, marrëdhënies së mbikëqyrjes dhe pjesëmarrjes në aktivitete që promovojnë interesat dhe vlerat e institucionit.*

Nisma për konkretizim

- Të organizohen aktivitete, të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve për periudhën pasuniversitare;
- Të sigurohet funksionimi i këshillave të të diplomuarve;
- Të organizohen takime periodike me të diplomuarit;
- Të ndiqen politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve;
- Të ndahen çmime për të diplomuarit me arritjet më të larta në profesion;
- Të ftohen të diplomuarit të referojnë tema të ndryshme para studentëve aktualë.

E. NDIKIMI I QËNDRUESHËM

Qëllimi

KUB synon të japë një kontribut intelektual, arsimor, edukativ, ekonomik, shkencor dhe kulturor për shoqërinë shqiptare e më gjerë, si dhe të ndikojë për nxitjen e mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes për institucionin dhe punën e tij.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. *Mbështetja e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, menaxhimit institucional dhe marrëdhënieve me komunitetin*

Nisma për konkretizim

- Të zhvillohen aktivitete studimore kërkimore, shkencore, kulturore dhe praktike, të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve, që zhvillohen në KUB;
- Të krijohen mundësi të të mësuarit dhe edukimit përmes trajnimeve akademike, hulumtimit shkencor dhe punës në praktikë ose inovacionit;

- Të rritet cilësia e mësimdhënies, nëpërmjet zbatimit të strategjive për trajnimin e stafit akademik dhe zbatimin në praktikë të dijeve teorike;
- Të përmbushen kërkesat aktuale të studentëve në fusha të ndryshme të arsimit dhe të ofrohen kurse dhe përkrahje shtesë;
- Të inkurajohen dhe të mbështeten studentët dhe gjimnazistët, duke organizuar konkurse dhe debate mbi problematikat dhe sfidat me të cilat përballlet shoqëria në ditët e sotme;
- Të nxiten lektorët e institucionit të mbajnë ligjërata në institucione të ndryshme të arsimit të mesëm dhe të lartë, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet përkatëse;
- Të forcohet bashkëpunimi me institucionet qendrore, lokale dhe ndërkombëtare në vendin tonë për të përmbushur vizionin dhe qëllimin e institucionit, si dhe integrimin në projektet afatgjata të edukimit;
- Të ndërtohet një komunitet “ALUMNI” sa më i gjerë dhe i mirinformuar, i angazhuar dhe përkrahës, përmes një kontakti të vazhdueshëm, duke organizuar takime dhe aktivitete periodike.

2. *Zhvillimi i vizionit të institucionit dhe rritja e kontributit të tij për një zhvillim të qëndrueshëm*

Nisma për konkretizim

- Të mbahen kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, lektorët shqiptarë dhe të huaj, që kanë qenë pjesë përbërëse e institucionit në periudha të ndryshme, në mënyrë që të ndërtohen ura bashkëpunimi dhe integrimi për stafin dhe studentët në programe që synojnë rritjen e kapaciteteve akademike, intelektuale, kulturore, sociale etj.;
- Të vlerësohet kontributi të diplomuarve dhe të behën përpjekje për rritjen përfshirjes së tyre në realizimin e misionit të institucionit, duke na shoqëruar në të sotmen dhe të ardhmen;
- Të inkurajohen dhe të mbështeten individët dhe ekipet e personelit dhe studentëve për të marrë pjesë në ngjarje sportive dhe në gara, duke ndërmarrë edhe aktivitete vullnetare, të nxitura nga institucioni ynë;
- Të ftohen qytetarët dhe anëtarët e komunitetit tonë të gjerë për të marrë pjesë në ligjërata, konferenca dhe aktivitete kulturore e sportive;
- Të mbështeten projektet dhe iniciativat, të cilat kanë si qëllim të ndihmojnë komunitetin dhe shtresat në nevojë;
- Të hapet enti botues i universitetit, me qëllim nxitjen e personelit akademik dhe të studentëve, për të botuar punimet dhe kërkimet e tyre shkencore;

- Të përfundojë kampusi universitar, që do të ofrojë të gjitha kushtet e logjistikës moderne, për të cilat universiteti ka nevojë.

F. PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Qëllimi

KUB synon të krijojë një mjedis në të cilin studentët, personeli dhe komuniteti i gjerë të ndihen të frymëzuar, të mbështetur dhe të angazhohen dhe të kontribuojnë në përgjegjësinë sociale, qëndrueshmërinë e institucionit dhe më gjerë.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. *Sigurimi i një mjedisi akademik që frymëzon dhe mbështet vlerat etike e shoqërore, komunitetin dhe përgjegjësinë sociale*

Nisma për konkretizim

- Të maksimizohet kontributi i institucionit për shoqërinë;
- Të ndërtohet një infrastrukturë, ku mund të operohet për të përmbushur qëndrueshmërinë mjedisore kombëtare dhe rajonale dhe objektivat e përgjegjësisë sociale;
- Të ruhen standarde të larta etike;
- Të përcaktohen çështjet sociale me prioritetit të lartë, nëpërmjet zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe të zhvillohet kërkimi dhe zbatimi i projekteve të hartuara;
- Të përcaktohen mjete dhe metoda të ndryshme komunikimi, përmes të cilave të ndahen me sektorët e interesuar të publikut rezultatet e veprimtarisë kërkimore të Kolegjit Universitar “Bedër”;
- Të organizohen programe dhe aktivitete arsimore, në mënyrë që të rritet përfshirja e publikut;
- Të organizohen aktivitete, seminare dhe trajnime mbi përgjegjësinë sociale, në bashkëpunim me universitete të tjera me qëllim shkëmbimin e eksperiencave;
- Të rritet mundësia e vizitës së publikut në ditë të caktuara, duke organizuar aktivitete shkencore dhe kulturore;
- Të motivohen të gjithë studentët dhe personeli i Kolegjit Universitar “Bedër” për t’u bërë më efektivë në mbështetje të praktikave më të mira, në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe qëndrueshmërinë.

2. *Nxitja e mbështetjes së grupeve të prekshme dhe shtresave në nevojë*

Nisma për konkretizim

- Të nxiten dhe të ftohen individë dhe studiues nga komuniteti për të publikuar punimet e tyre, lidhur me shtresat në nevojë, në revistat shkencore të institucionit;
- Të inkurajohen dhe mbështeten shtresat në nevojë dhe grupe të ndryshme shoqërore, duke ofruar bursa studimi për kategori të veçanta;
- Të bashkëpunohet me autoritetet arsimore dhe pushtetin vendor për të vijuar projektet arsimore për shtresat në nevojë.

G. BURIMET NJERËZORE

Qëllimi

KUB synon të ofrojë mbështetje të plotë për zhvillimin dhe promovimin e personelit akademik dhe administrativ. Edukimi, trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm janë pikat më të rëndësishme në të cilat përqendrohet zyra e burimeve njerëzore.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. *Nxitja dhe mbështetja e politikave që sigurojnë punësimin dhe mbajtjen e një personeli profesional dhe produktiv*

Nisma për konkretizim

- Të konsolidohet kultura kolegjiale e tolerancës dhe etikës në punë, e angazhimit të drejtpërdrejtë të punonjësve dhe e rritjes së transparencës;
- Të përditësohen politikat dhe struktura e shpërblimeve për arritjet e personelit;
- Të rishikohen fushat dhe nivelet e studimit për çdo pozicion të caktuar pune;
- Të kryhen kualifikime dhe specializime të mëtejshme për zhvillimin e aftësive të stafit të institucionit, duke investuar në programe të zhvillimit profesional, për të përmirësuar aftësitë dhe produktivitetin në punë të personelit;
- Të informohet personeli mbi rëndësinë e edukimit, vetëkujdesit dhe etikës së sjelljes për përmirësimin e klimës në punë;
- Të nxitet bashkëpunimi me individë dhe departamente edhe jashtë institucionit, për të zgjeruar gamën e shërbimeve të ofruara;
- Të shtohen shërbimet 'online' nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit BIS për të përmirësuar proceset e shërbimit të zyrës së burimeve njerëzore;
- Të kryhet anketimi i rregullt i personelit, lidhur me përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga zyra e burimeve njerëzore, vlerësimet sistematike organizative dhe bashkëpunimi me zyrat e tjera për të përmirësuar klimën e punës në institucion;
- Rekrutimi i personelit të ri të bazohet në diversitet;
- Të krijohen mundësi për rekrutimin e një numri më të lartë të personelit akademik të huaj dhe të nxitet larmia për një mjedis të tillë pune.

H. INFRASTRUKTURA DHE BURIMET FINANCIARE

Qëllimi

KUB synon të sigurojë një bazë financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë dhe shërbime të përshtatshme për një sistem modern edukimi dhe mjedis social, të cilat kontribuojnë në forcimin dhe përmbushjen e synimeve strategjike.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

1. Hartimi dhe mbështetja e politikave që sigurojnë qëndrueshmëri financiare, një infrastrukturë dhe sistem modern të arsimit të lartë

Nisma për konkretizim

- Të sigurohet qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e cilësisë dhe përvojës së krijuar në infrastrukturë, duke përfshirë të gjitha elementet fizike, teknologjinë tonë të informacionit (IT), bibliotekën dhe shërbimet;
- Të ofrohen lehtësi dhe shërbime cilësore për të gjithë personelin dhe studentët, të menaxhuara në mënyrë efektive;
- Të adresohen nevojat e vazhdueshme për përmirësimin e hapësirave dhe standardizimin e kushteve fizike të ambienteve studimore dhe hapësirave të përbashkëta;
- Të përfundojë ndërtimi i kampusit të Kolegjit Universitar “Bedër”;
- Të sigurohen standarde të larta të përgjegjësisë, integritetit dhe kontrollit financiar;
- Të shqyrtohen dhe të përditësohen strategjitë financiare afatshkurtra dhe afatmesme, duke kryer vlerësime vjetore periodike të stabilitetit financiar;
- Të sigurohen dhe të menaxhohen fondet për të mbështetur investimet në infrastrukturë dhe zhvillimin e aktiviteteve akademike e sociale, si dhe kontrolli i shpenzimeve;
- Të inkurajohen njësitë akademike për të marrë pjesë në projekte ndërkombëtare me financim të jashtëm;
- Të sigurohen të ardhura nga të tretët, duke u ofruar atyre konsulencë në baza kontraktuale;

- Të mundësohen studime akademike për raste dhe grupe të caktuara sociale, ku studentët aplikojnë për mbështetje financiare përmes bursave.